



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. _____ Prot

Vlorë, më _____ 2023

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Për: **RAFIN COMPANY sh.p.k**

Seli/Zyra Qendrore:

Tirane, Njësia Bashkiake nr. 5, rruga "Gjik Kuqali", godinë banimi 6-8 kate dhe 2 kate nëntokë, kati 1, apartamenti nr.4, seksioni 2, pallati "C & S"

Adresa:

1. Tirane, Ndroq, Shesh, Zona kadastrale Nr. 3363, Numer Pasurie 402/30

2. Tirane, Paskuqan, Babrru Qender, Shkolla 9-vjecare "Lidhja e Prizrenit", Njësia administrative Paskuqan

Procedura e prokurimit/lotit: **PROCEDURE E HAPUR, MALL**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-82846-10-09-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Ndriçim i rrugës "Rruga e Pishave-Zvërnec-Manastir""**

30 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimin e Operatoreve (BOE)

ELAL COM sh.p.k me Nipt K724180100 dhe T & XH sh.p.k me Nipt L72121504I

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **12.863.600** (dymbëdhjetë million e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind)lekë pa TVSH;

2. NDERTUESI 2000 sh.p.k me Nipt J96409033R

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13.538.000** (trembëdhjetë million e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë)lekë pa TVSH.

3. Bashkimin e Operatoreve (BOE)

MURATI sh.p.k me Nipt J66702413V dhe LIS KONSTRUKSION sh.p.k me Nipt K66613407H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13.811.500** (trembëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH,

4. AVDULI sh.p.k Nipt J66703306O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**13,816,200** (trembëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH,

5. ASI-2A CO sh.p.k me Nipt K53992402C

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **14,292,000** (katërmëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH,

6. EURONDERTIMI sh.p.k me Nipt K02003001O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**14,999,520** (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzetë) lekë pa TVSH,

7. Bashkimin e Operatoreve (BOE)

NEWGEN sh.p.k me Nipt L92014008U dhe INERTI sh.p.k me Nipt J66926804L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **15,470,480** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH,

8. AIDA KONSTRUKSION sh.p.k me Nipt M03116403C

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme**15,552,400** (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë pa TVSH,

9. ECEL sh.p.k me Nipt M01721014S

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **15,676,220 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë) lekë pa TVSH,**

10. BEQIRI sh.p.k me Nipt J98624801V

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,124,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzetë e katër mijë) lekë pa TVSH,**

11. RAFIN COMPANY sh.p.k me Nipt L52125110A

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,333,800 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë pa TVSH,**

12. ABG Ndertim sh.p.k me Nipt K03816401O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,730,632 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH,**

13. SARK sh.p.k me Nipt K52531415H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,960,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH,**

14. AA&P sh.p.k me Nipt L61713009Q

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,976,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH,**

15. “SHKELQIMI 07” sh.p.k me Nipt K68121808W

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **17,000,000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH,**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimin e Operatoreve (BOE)

ELAL COM sh.p.k me Nipt K72418010O dhe T & XH sh.p.k me Nipt L72121504I

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **12.863.600 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind)lekë pa TVSH**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se BOE

nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim Shtojca 3, pika 2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kerkese do të konsiderohet e permbushur nëqë dy bilancet e njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të Autorizuar për zërat e artikujve si më poshtë vijon: Shtyllë metalike, Ndricues Led, Elektroda tokëzimi profil zingato e bakterizuar, Pusetë plastike, Tubo fleksibël. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, eëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

2.3.7 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP 1 - A (Punime gërmimi në tokë)
- NP-11 A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërnarjen e energjisë elektrike.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

2. NDERTUESI 2000 sh.p.k me Nipt J96409033R

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13.538.000 (trembëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim Shtojca 3, Sigurimin e ofertës, Pra sa më sipër operatori ekonomik "NDËRTUESI 2000" shpk nuk ka paraqitur vlerën e sigurimit të ofertës referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit shtojca "Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit", 2.3.9 Në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.9 është kërkuar : Eskavator me goma 1 cope , në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik " NDËRTUESI 2000" shpk ka deklaruar në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" automjetin sa më poshtë:

1. *Eskavator me goma 0.25 m³ në pronësi për të cilin nuk ka deklaruar targën dhe referencat e tjera për mjetet që qarkullojnë në rrugë, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

3. Bashkimin e Operatoreve (BOE)

MURATI sh.p.k me Nipt J66702413V dhe LIS KONSTRUKSION sh.p.k me Nipt K66613407H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13.811.500 (trembëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se BOE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim Shtojcen 3, Në udhëzime për operatorët ekonomikë është kërkuar periudha e vlefshmerisë së ofertës 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Nga verifikimi i Formularit të sigurimit të ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik Murati shpk & Lis Ndertim shpk konstatohet se sigurimi i nuk plotëson periudhën e vlefshmerisë së ofertës 150 dite, pasi sigurimi i ofertës se dorëzuar është leshuar në datë 26.10.2023 dhe është i vlefshëm deri në datë 23.03.2024 vetëm për 146 ditë. NE DT sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm për 150 ditë duke filluar duke perlloritur nga data e hapjes së ofertave pra fillon në datë 30.10.2023 dhe është i vlefshëm deri në datë 27.03.2024.

Ne Udhëzime për operatorët ekonomikë përcaktohet specifikisht:

*Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates **pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor;** Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.*

Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomik ka paraqitur periudhë më të shkurtër vlefshmërie se periudha e kërkuar në dokumentat e tenderit dhe për rrjedhojë sigurimi i ofertës nuk është i vlefshëm. 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,*
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe*

të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Murati shpk konstatohet se është paraqitur kontrata për punime ndertimi me objekt "Rivitalizimi i qendres Gose e plote" e lidhur me datë 26.12.2018. Zbatimi i kontratës ka filluar me datë 26.12.2018 dhe ka mbaruar në datë 25.08.2020. Për kontratën është jashtë afatit 3 vjeçar sikundër në kriterin përcaktuar. Kontrata është kontratë FV malli dhe afati është jashtë afatit të përcaktuar referuar Nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për sa më sipër konstatuar operatori ekonomik Murati shpk si anëtar i BOE nuk verteton se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kriterin sipas pikës 2.3.1 të kriterëve të vecanta për kualifikim.

Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë kërkuar:

Për ndricuesit e paraqitur në katalog nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme se cilin nga artikujt e përcaktuar në katalog ofron prodhuesi për realizimin e furnizimit dhe gjithashtu specifikimet teknike të përcaktuara në katalog nuk janë të plota referuar specifikimeve teknike përcaktuar në dokumentat e procedurës.

Referuar dokumentacionit të paraqitur përkatësisht aktmarrëveshjes së bashkëpunimit datë 27.10.2023 shoqëria Murati shpk ka marrë përsipër të kryejë 57.36 % të punimeve dhe Lis Konstruksion shpk 42.64%. Shoqëria Murati shpk ka marrë përsipër të realizojë 57.36 % të punimeve, referuar preventivit të ndarjes së punimeve ka marrë përsipër të kryejë F.V. Shtyllë metalike me gjatësi $H = 8.8\text{m}$, e zinguar në tërësi dhe pajisur me krah $L = 1\text{m}$, F.V. Morsete, kapak, siguresë, FV Kabëll alumini $4 \times 16\text{mm}$, FV Elektroda tokëzimi, profil zingor dhe bakëzuar, $L = 1\text{m}$, FV Panel metalik IP65 ($700 \times 550 \times 250\text{mm}$) FV Përcjellës $1 \times 10\text{mm}$ për tokëzimin, F.V. Automat magnetotermik 380V, 25A, 4P, F.V. Automat termoelektrik/manj. diferencial 2P 220V, 63A, F.V. Pusete plastike 30×30 , F.V. Lëshues manjeto termik 4P 40A, nderkohe në deklarinë e dhënë në shtojcën 8 Formulari përmbledhës I vetdeklarimi OE Murati nuk disponon punonjës elektrikist në raport me përqindjen e marrë nga aktmarrëveshja e bashkëpunimit për punimet elektrike të cilat ka marrë përsipër të realizojë.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen dhe natyrën e shërbimeve të marra përsipër. Operatorët ekonomikë të cilët vendosin të konkurojnë si një bashkim operatorësh ekonomikë në një procedurë prokurimi, duhet ta zyrtarizojnë këtë bashkim nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, në të cilën kanë detyrimin të përcaktojnë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në këtë kontratë. Nisur nga përqindja e përcaktuar në këtë kontratë, si edhe zërat e shërbimeve të marra përsipër nga secili prej anëtarëve, bëhet edhe verifikimi i përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

4. AVDULI sh.p.k Nipt J667033060

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13,816,200 (trembëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim *Referuar dokumentacionit te dorezuar ne SPE operatori ekonomik nuk ploteson pike 2.1.b Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në udhëzime për operatorët ekonomikë është kërkuar periudha e vlefshmerisë së ofertës 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Nga verifikimi i Formularit të sigurimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Avduli” shpk konstatohet se sigurimi nuk ploteson periudhen e vlefshmerise se ofertes 150 dite, pasi sigurimi ofertes se dorezuar eshte leshuar ne date 28.10.2023 dhe eshte i vlefshem deri ne date 25.03.2024 vetem per 148 dite.NE DT sigurimi i ofertes duhet te jetë i vlefshem për 150 dite duke filluar nga data e hapjes se ofertave pra fillon ne date 30.10.2023 dhe eshte i vlefshem deri ne date 27.03.2024.*

Ne Udhëzime per operatoret ekonomike percaktohet specifikisht:

*Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates **pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor;** Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.*

Sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur periudhë më të shkurtër vlefshmërie se ofertës se periudha e kërkuar në dokumentat e tenderit dhe për rrjedhojë sigurimi i ofertës nuk është i vlefshem.

*Referuar dokumentacionit te dorezuar ne SPE operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.3 ”operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtare ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku tëspecifikohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST” Ne dokumentin e paraqitur me emertimin Autorizime & Kataloge Avduli shpk ne faqen 40 Oe ka paraqitur skede teknike tub plastik me prodhuesin **ITIB Machinery International spa**. Skeda teknike eshte e paperkthyer dhe e pa noterizuar. Ne piken 2.3.3 cilesohet “Fleta/pjeset e katalogut/broshurës ose skedave teknike që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara”.*

Operatori ekonomik nuk permbush piken 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Distributori të Autorizuar për zërat e artikujve si më poshtë vijon: Tubo fleksibël Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Operatori ekonomik Avduli shpk nuk ka paraqitur marreveshje angazhimi midis RIA PLASTIC dhe ITIB Machinery International spa.

Operatori ekonomik AVDULI shpk nuk ka paraqitur katalog/ skede teknike per shtyllat elektrike ku te percaktohen te dhenat teknike mbi produktin. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se është paraqitur nje skede teknike ku percaktohen vetem permasat e shtylles dhe asnjë parametër tjetër teknik me qëllim verifikimin e përmbushjes së parametrave teknik te produktit referuar specifikimeve teknike.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur te perkthyer ne shqip te dhenat per puseten plastike referuar percaktimit bërë në dokumentat e tenderit.

*Nga verifikimi i materialit te dorezuar ne SPE autorizime & katalog AVDULI konstatohet se nje pjesë e dokumentacionit jane fotokopje te cilat kanë vërtetimin e perkthimit ne referim te Nenit 135, te Ligjit Nr.110, date 20.12.2018 “Per noterine” por nuk kane vertetim njehsimi me origjinalin në referim të Nenit 62 shkronja “i” dhe Nenit 129 te ligjit Nr.110 date 20.12.2018 “Per noterine”, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

5.ASI-2A CO sh.p.k me Nipt K53992402C

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **14,292,000 (katërmëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH,**

*Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim *ne pikat 2.3.3 dhe 2.3.4*”operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtare ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku tëspecifikohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST”. Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga Sali elektrik.*

V.Tac Europe ka paraqitur autorizim prodhuesi per Sali elektrik por autorizimi eshte me afat deri ne 31.12.2022 pra eshte jashte afatit dhe per pasoje ne daten e hapjes se procedures distributori Sali elektrik nuk ka te drejten te operoje me prodhuesin Vtac Europe dhe tja ofroje keto produkte ASI-2A Co per pjesemarrje ne procedure.

Kompania IBV ka paraqitur autorizim prodhuesi te perkthyer para noterit per Sali elektrik por nga verifikimi i produkteve dhe katalogeve te paraqitur konstatohet se nuk jane paraqitur produkte te IBV te cilat te perputhen me produktet e kerkuara ne proceduren e prokurimit

Kompania OMS ka paraqitur autorizim prodhuesi te perkthyer para noterit per Sali elektrik por nga verifikimi i produkteve dhe katalogeve te paraqitur konstatohet se nuk jane paraqitur produkte te OMS te cilat te perputhen me produktet e kerkuara ne proceduren e prokurimit.

Kompania Pedrollo ka paraqitur autorizim prodhuesi te perkthyer para noterit per Sali elektrik por nga verifikimi i produkteve dhe katalogeve te paraqitur konstatohet se nuk jane paraqitur produkte te Pedrollo te cilat te perputhen me produktet e kerkuara ne proceduren e prokurimit.

Eshte paraqitur autorizim prodhuesi nga ICEL i perkthyer i cili i mbaron afatet me date 31.12.2019 dhe gjithashtu eshte paraqitur autorizim prodhuesi perseri nga ICEL i cili nuk ka afat te percaktuar por eshte i paperkthyer . Pra sa më sipër autorizimi i prodhuesit i cili eshte i perkthyer eshte jashte afatit dhe per pasoje ne daten e hapjes se procedures distributori Sali elektrik nuk ka te drejten te operoje me prodhuesin ICEL dhe tja ofroje keto produkte ASI 2A &Co per pjesemarrje ne procedure.Dhe autorizimi tjeter i paraqitur i cili nuk ka afat te percaktuar eshte i paperkthyer dhe noterizuar pra nuk eshte dokumentacion i vlefshem.

Eshte paraqitur autorizim prodhuesi nga Legrand te perkthyer para noterit per Sali elektrik por autorizimi eshte me afat vlefshmeri deri ne 31.12.2019 pra eshte jashte afatit dhe per pasoje ne daten e hapjes se procedures distributori Sali elektrik nuk ka te drejten te operoje me prodhuesin Legrand dhe tja ofroje keto produkte ASI 2A &Co per pjesemarrje ne procedure.

Kompania NCM ka paraqitur autorizim prodhuesi per Sali elektrik por autorizimi eshte i paperkthyer i panoterizuar per rrjedhoje nuk eshte dokumentacion i vlefshem.

Sa me siper konstatohet ASI 2A CO nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt per elektroda tokezimi, puseta plastike dhe Tubo flesibel.Dokumentacioni ne emertimin Autorizim Katalog tub elektroda ndricues eshte i pasakte dhe i palexueshem faqet (24,25,26,27) Dokumentacioni nuk eshte ne formen e sakte ligjore pasi ne perberje ka njehsime te 3(tre) notereve dhe fletet nuk jane te lidhura me vulat perkatese sipas noterit qe niset njehsimi.

*Ne dokumentacionin e paraqitur me emertimin “autorizim katalog shtyllat, autorizimi i dates 23.10.2023 me Jiangsu Waffley Lighting Group Co., Ltd nuk eshte I njehesuar me origjinalin, nuk eshte i perkthyer nga perphyes te miratuar. Katalogu i paraqitur nga prodhuesi Jiangsu Waffley Lighting Group Co., nuk eshte I njehesuar me origjinalin perpara noterit dhe nuk eshte I perkthyer nga perkthyes te licesuar, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

6.EURONDERTIMI sh.p.k me Nipt K02003001O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme 14,999,520 (katërmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e njëzetë) lekë pa TVSH,

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim, Operatori ekonomik “Eurondertim” shpk me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti është mbështetur në kapacitetet e subjektit “Everest” shpk.Referuar dokumentacionit te paraqitur perkatesisht Shtojca 8 Formulari i vetdeklarimit OE Eurondertimi ka deklaruar ne deklaraten B si subjekt mbeshtetes Everest shpk per punonjesin manovrator Lufti Ademaj.

Ne Ligjin 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ligjvënësi përcakton sa më poshtë:

Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE konstatohet se nuk është paraqitur angazhimi me shkrim i operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Eurondertim 2000” dhe subjektit mbështetës Everest në kundërshtim me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Operatori ekonomik autorizim distributori nga Alba elettrica i cili deklaron se është distributor eskuziv i kompanive L.D.Ts.r.l, Ledvance gmbh dhe Arnocanali spa.

Gjithashtu janë paraqitur autorizimet e prodhuesit për distributorin por janë të papërkthyer në gjuhën shqipe dhe të panoterizuara.

Referuar krahasimit të specifikimeve teknike të produktit ndricues të paraqitur me ato të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit konstatohet se fuqia e ndricuesit është 90Ë nga 100 W të kërkuar në specifikimet teknike.

Gjithashtu është kërkuar në specifikimet teknike që permasat e ndricuesit të jenë Lartësi 10-12cm, Gjerësia: 22-25cm dhe Gjatësia: 50-55cm dhe me peshe jo më pak se 2.5kg.Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi konstatohet se ka paraqitur ndricues me permasat Lartësi: 9.1, gjerësi 21,6 cm dhe gjatësi 55,2 cm pra nuk plotëson specifikimet e kërkuara.

Operatori ekonomik ka deklaruar se do të furnizohet me tubo fleksibel nga RIA Plastik por katalogu i paraqitur nga RIA është i papërkthyer dhe noterizuar sikundër kërkuar në kriterin përcaktues.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur skeda/fragmente/kataloge për tubat fleksibel.

*Nga verifikimi i materialit të dorëzuar në SPE konstatohet se një pjesë e dokumentacionit janë fotokopje të cilat kanë vërtetimin e përthimit në referim të Nenit 135, të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 “Për noterine” por nuk kanë vërtetim njëhësisht me origjinalin në referim të Nenit 62 shkronja “i” dhe Nenit 129 të ligjit Nr.110 datë 20.12.2018 “Për noterine”, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

7. Bashkimi i Operatoreve (BOE)

NEWGEN sh.p.k me Nipt L92014008U dhe INERTI sh.p.k me Nipt J66926804L

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **15,470,480 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se BOE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikimreferuar marrëveshjes së bashkëpunimit datë 28.10.2023 kanë rënë dakor se përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e projektit është 80% NEWGEN shpk dhe 20% INERTI shpk. Referuar shtojcës 8 Formulari përmbledhës I

vetwdeklarimit ne kapacitetet e deklaruar nga shoqeria NEWGEN shpk e perkatesisht referuar nr te punonjesve 11 persona, I takojne 73% dhe jo 80% . Ndarja e % te BOE eshte e pasakte dhe jo ne porcion me kapacitetet qe ata zoterojne. Sa më sipër operatori ekonomik Neë Gen nuk plotëson numrin e punonjësve në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4.

Operatori ekonomik ka paraqitur autorizimet e prodhuesit nga ICEL dhe Vtac per Sali elektrik por nuk ka autorizim distributori te Sali elektrik per kompanite pjesemarrrese ne procedure per rrjedhoje ne kushtet e mungeses se autorizimit te distributorit dokumentacioni i paraqitur ne lidhje me piken 2.3.2 dhe 2.3.3 nuk mund te merret ne konsiderate dhe konsiderohet i pavlefshem nga komisioni i vleresimit te ofertave.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur në SPE konstatohet se marreveshja e angazhimit V_TAC-Sali elektrik eshte e sakduar ne date 31.12.2022, dhe gjithashtu eshte e papekthyer e pa noterzuar duke mos plotesuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.2.

Dokumentacioni i paraqitur ne emrin

AUTORIZME_ISO_KATALOG_LEJE_PRODHUESI_DISTRIBUTORI nuk eshte i perkthyer dhe i noterizuar sikunder kerkohet ne dokumentat e tenderit.

Nga verifikimi i shtojces 8 te paraqitur nga operatori ekonomik konstatohet se ne piken II A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT eshte plotesuar shtojca gabim pasi subjekti deklaroi vertetimin e pikave sa me poshte me vetdeklarim:

- a) Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: LILJANA KOLA / ID G76214075P – ne cilesine e administratorit te shoqerise ortak i vetem i "NEWGEN" shpk. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. **Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vetedeklarim Subjekti**
- b) Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. **Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vetedeklarim Subjekti**

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

8.AIDA KONSTRUKSION sh.p.k me Nipt M03116403C

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **15,552,400 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë pa TVSH**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim,

*Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim nga distributori ITE Group dhe autorizim nga prodhuesi VIMAR, por nuk ka paraqitur katalog apo skeda teknike per asnje nga produktet e kerkuara ne iken 2.3.2, sa me sipër operatori ekonomik nuk ploteson kriterin 2.3.3 te kriterëve te vecanta te kualifikimit, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

9. ECEL sh.p.k me Nipt M01721014S

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **15,676,220 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga ITE Group dhe autorizimet e prodhuesit Zippo, LDT Optonical dhe Electrocanali, por nw plotësimin e pikës 2.3.3 ka paraqitur katalog nga LDT pwr elektrodën e tokësimit, pusetat dhe shtyllat, por katalogu është i papërkthyer në gjuhën shqipe dhe i panoterizuar.

Në kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.3 përcaktohet sa më poshtë.

*Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të specifikohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). **Fleta/pjesët e katalogut/broshurës ose skedave teknike që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.***

Pra ne plotësimin të kërkesës së autoritetit kontraktor katalogjet skedat teknike duhet të paraqiteshin të përkthyer dhe noterizuara nga operatori ekonomik.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor duke mos plotësuar pikën 2.3.7 të kriterëve të vecanta për kualifikim.

Sqarohet se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga

autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta plotësojë atë, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

10. BEQIRI sh.p.k me Nipt J98624801V

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,124,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzetë e katër mijë) lekë pa TVSH**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikimb. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Operatori ekonomik “BEQIRI” shpk ka paraqitur sigurimin e ofertës nga kompania ANSIG sha ne vleren 362.857,04 (treqind e gjashtëdhjetë e dymijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje zero katër) lek.

Ne mbështetje te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30 pika 3 përcaktohet specifikisht:

“Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit¹”.

Pra vlera e sigurimit të ofertës referuar fondit limit të procedurës është 18,292,852.00 (tetëmbëdhjetë million e dyqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) X 2 % = 365.857,04 lek.

Ne modifikimin e bërë në dokumentat e tenderit nepermjet shtojces për modifikim autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën e saktë të sigurimit të ofertës sa 2% e vlerës së fondit limit te përcaktuar e cila është 365.857,04 (treqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë presje zero katër).

Pra sa më sipër operatori ekonomik “BEQIRI” shpk nuk ka paraqitur vlerën e sigurimit të ofertës referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe përcaktimit te bere ne dokumentat e tenderit shtojca “Njoftim për ndryshimin e dokumentave të tenderit”.

Nuk ka paraqitur kontrata te ngjashme ka paraqitur fature tatimore leshuar per bashkine dures per kontraten me objekt “Rehabilitim i ndricimit te akteve rrugore” por nuk ka paraqitur kontraten dhe vertetimin e realizimit te kesaj kontrate leshuar nga bashkia dures sikunder specifikuar ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.1, germa a.

Ka paraqitur kontrate furnizimi me Sali elektrik te lidhur me date 10.05.2017 ku Sali elektri merr persiper te furnizoje Beqiri shpk specifikisht me artikujt e meposhtem:

¹Shtuar meVendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Shtylle konike 9 ml Leo me nje krah te perfshire te gjithë aksesoret.

Shtylle konike 6ml, Leo me nje krah te perfshire te gjithë aksesoret.

Puseta plastike 40X40X40 me kapak te forte RIC 1084+1086

Kabllo CU fuqie -1000V me izolim gome e mbulese plastmasi te arnuar 4X10mm²

Kabllo CU fuqie -1000V me izolim gome e mbulese plastmasi te arnuar 4X25mm²

Percjelles CU me izolim gome per ndricim me sek 1X2.5 mm²

Kuder komandimi komplet me automat dhe fotoelement

Tubacion shllang d-80 mm

*Sikunder percaktuar ne kontraten e furnizimit asnje nga produktet objekt i kesaj kontrate nuk eshte produkt i specifikuar ne specifikimet teknike percaktuar ne dokumentat e tenderit per kete procedure.**Thënë kjo Operatori ekonomik BEQIRI sh.p.k nuk ka paraqitur autorizim/marreveshje angazhimi per materialet :Ndricues Led, Elektroda tokëzimi profil zingato e bakterizuar, Tubo fleksibël***

Marreveshja e angazhimit Legrand Sali elektrik eshte e skaduar ne date 31.12.2022, e pa perkthyer e panoterizuar.

Marreveshja e angazhimit ICEL- Sali elektrik eshte e skaduar ne date 31.12.2022, e pa perkthyer e panoterizuar.

Marreveshja e angazhimit NUPAX ITALIA- Sali elektrik eshte e skaduar ne date 31.12.2022, e pa perkthyer e panoterizuar.

*Gjithashtu jane paraqitur nga operatori ekonomik kataloge qe nuk i perkojne prodhuesit dhe jane te paperkthyer.Ne gjithë dokumentacionin e paraqitur nuk ka vertetime perkthimi dhe noterizimi Sa me siper operatori ekonomik Beqiri shpk nuk ploteson pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 te kriterëve te vecanta per kualifikim. Kapaciteti teknik, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

11. ABG Ndertim sh.p.k me Nipt K038164010

*Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,730,632 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH,***

*Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se *OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim, Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim distributori nga Sali elektrik.**

ICEL ka paraqitur autorizim prodhuesi per Sali elektrik por autorizimi eshte me afat deri ne 31.12.2019 pra eshte jashte afatit dhe per pasoje ne daten e hapjes se procedures distributori Sali elektrik nuk ka te drejten te operoje me prodhuesin ICEL dhe tja ofroje keto produkte ABG Ndertim per pjesemarrje ne procedure.(tuba flesibel)

*Ka paraqitur elektroda tokezimi dhe puseta plastike nga RIA plastik por nuk ka autorizim prodhuesi nga RIA plastik, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

12. SARK sh.p.k me Nipt K52531415H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,960,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH,**

*Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se *OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim, Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar punonjes shofer jo punonjes manovrator duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.5 ku është kërkuar 1 punonjes manovrator.**

Eshte paraqitur autorizim nga distributori Sali elektrik per tubo, kabllo, percjellesa alumin dhe alumin me zemer celiku TU, TM, TN dhe AAC por nuk eshte vertetuar lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Gjithashtu nuk jane paraqitur katalogje ose fragmente te katalogut dhe as skeda teknike per artikujt e ofruar duke mos permbushur pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik.

Eshte paraqitur autorizim nga distributori Sali elektrik per kabllo te llojeve te ndryshme te prodhuara nga kompania ICEL por nuk eshte vertetuar lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Gjithashtu nuk jane paraqitur katalogje ose fragmente te katalogut dhe as skeda teknike per artikujt e ofruar duke mos permbushur pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik.

*Eshte paraqitur autorizim nga distributori Sali elektrik per ndricuesa te prodhuar nga V-TAC por nuk eshte vertetuar lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Gjithashtu nuk jane paraqitur katalogje ose fragmente te katalogut dhe as skeda teknike per artikujt e ofruar duke mos permbushur pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.***

13. AA&P sh.p.k me Nipt L61713009Q

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,976,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH,**

*Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se *OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim, Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar 4 punonjes duke mos plotësuar kriteret e**

vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4 ku eshte kerkuar nje numer mesatar prej 15 (pesëmbëdhjetë) punonjesish.

Nga verifikimi i formularit te vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar eskavator me zinxhir nderkohe qe ne kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik eshte kerkuar mjet Eskavator me goma.

Operatori ekonomik ka paraqitur autorizim prodhuesi nga Feman Jagodina ku nga verifikimi i specifikimeve teknike konstatohet se permasat e ndricuesve nuk perputhem me permasat e kerkuara ne specifikimet teknike. Ne specifikimet teknike percaktohet Ndricuesit duhet te jene me këto përmasa: Lartësi 10-12cm, Gjerësia: 22-25cm dhe Gjatësia: 50-55cm ndersa ne skeden teknike per ndricues 100Ë jane percaktuar ndricues me permasa Gjatësia: 60 cm, Gjeresia 25 cm dhe Lartesia 23 cm, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

14. “SHKELQIMI 07” sh.p.k me Nipt K68121808W

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **17,000,000 (shtatëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim, Ka paraqitur kontrate furnizimi me Sali elektrik me te cilen furnitori merr persiper te furnizoje operatorin ekonomik Shkelqimi 07 me materiale te ndryshme elektrike por nuk ka paraqitur lidhjen e furnitorit me prodhuesin dhe gjithashtu nuk ka paraqitur katalogje ose fragmente te katalogut dhe as skeda teknike per artikujt e ofruar duke mos permbushur pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim kapaciteti teknik.

Ka paraqitur kontrate furnizimi me A& E Mucaj por produktet qe ofron ky furnitor nuk jane produktet te cilat kerkohen ne proceduren objekt prokurimi.

Ka paraqitur kontrate furnizimi me Hidrosistem por produktet qe ofron ky furnitor nuk jane produktet te cilat kerkohen ne proceduren objekt prokurimi.

Pra sa me siper ne lidhje me produktet e ofertuara operatori ekonomik shkelqimi 07 nuk ka paraqitur tr dhena mbi specifikimet teknike te tyre duke krijuar pamundesine e verifikimit nese keto produkte jane ato te specifikuara ne dokumentat e tenderit dhe duke mos permbushur pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim, për këtë arsye **e shpall të pavlefshme këtë ofertë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“RAFIN COMPANY”sh.p.k** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **16,333,800 (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë pa TVSH** / pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ermal DREDHA